



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.3160/14 prot.

Datë 06.02.2024

**V E N D I M**

**Nr. 151/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Tërnova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 101/2024, datë 26.01.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-88061-11-17-2023, me objekt: “Sektori i Pastrimit, Uniforma”, me fond limit 2,500,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 30-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK me NIPT L82729403H dhe adresë: Zharëz, Fshati Frashër, Patos, Fier.
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë  
Lagjja: “Kushtrimi”, Ish Parku Urban.
- Subjekte të Interesuara:** “Star Trade Albania” SHPK me NIPT L82309028R dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Ymer Kurti”, Pallati 2/1, Apartamenti 3, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 26.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 101/2024, ku vendosi:  
[...]

1. *Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-88061-11-17-2023, me objekt: “Sektori i Pastrimit, Uniforma”, me fond limit 2,500,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Vlorë.*
2. *Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Star Trade Albania” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.*
3. *T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimeve në bazë të konstatimeve të bëra në këtë vendim.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Bregu Company” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 40/7 prot., datë 02.02.2024, protokolluar me tonën nr3160/11 prot., datë 05.02.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 101/2024, datë 26.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-88061-11-17-2023, me objekt: “Sektori i Pastrimit, Uniforma”, me fond limit 2,500,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Vlorë.

### II

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

**Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 40/7 prot., datë 02.02.2024, protokolluar me tonën nr.3160/11 prot., datë 05.02.2024, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 101/2024, datë 26.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-88061-11-17-2023, me objekt: “Sektori i Pastrimit, Uniforma”, me fond limit 2,500,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Vlorë.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.101/2024, datë 26.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit duke skualifikuar operatorin ekonomik “Star Trade Albania” SHPK, në zbatim të vendimit Nr.101/2024, datë 26.01.2024 të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-88061-11-17-2023, me objekt: “Sektori i Pastrimit, Uniforma”, me fond limit 2,500,000 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 30.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Vlorë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

